- I. Aprovohet kërkesa e parashtrues të kërkesës _____, i përfaqësuar sipas autorizimit nga _____, ku bartësi i së drejtës banesore: _____ (tani e ndjerë) me numër KB-1772/23 përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 18.02.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "UTI-Emin Duraku" Gjakovë (PEJ110).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banësive të datës 18.02.2025 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës: _____, i përfaqësuar sipas autorizimit nga _____, ku bartësi i së drejtës banesore: _____ (tani e ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "UTI-Emin Duraku" Gjakovë (PEJ110).


Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/8

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës [redacted] e përfaqësuar sipas autorizimit nga [redacted] me numër KB-1771/23 përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.02.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "UTI-Emin Duraku" Gjakovë (PEJ110).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.02.2025 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës: [redacted] e përfaqësuar sipas autorizimit nga [redacted] për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "UTI-Emin Duraku" Gjakovë (PEJ110). Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/9

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e parashtrueses të kërkesës _____, e përfaqësuar sipas autorizimit nga _____, ku bartësi i së drejtës banesore është (tani i ndjerë) me numër KB-1771/23 përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.02.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "UTI-Emin Duraku" Gjakovë (PEJ110).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.02.2025 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e parashtrueses të kërkesës: _____ i përfaqësuar sipas autorizimit nga _____, ku bartësi i së drejtës banesore është _____ (tani i ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "UTI-Emin Duraku" Gjakovë (PEJ110).

Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/10

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e narashtrueses të kërkesës [Blank Space], ku bartësi i së drejtës banesore janë [Blank Space] (tani të ndjerë) me numër KB-1812/24 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.02.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Universal" Prizren (PRZ015).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.02.2025 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtrueses të kërkesës [Blank Space] ku bartësi i së drejtës banesore janë [Blank Space] (tani të ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Universal" Prizren (PRZ015).. Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se pala nuk posedon Vendim mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim dhe Kontrata mbi shfrytëzimin e banesës. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).

Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/11

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës [] ku bartës i të drejtës banesore është (tani e ndjerë) me numër KB-1735/23e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.02.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh KBI – Kosova Export, Prishtinë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.02.2025 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës [] ku bartës i të drejtës banesore është []

(tani e ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh PIK – Kosova Export, Prishtinë. Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si “Ligji për Shitjen e Banesave”) lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe vërtetohet se mungon legjitimiteti i palëve në procedurë. Gjithashtu, komisioni gjeti se bartësja e të drejtës banesore [] tani e ndjerë, në vitin 1998 e kishte shitur banesën babait të parashtruesit të kërkesës [] para se të vdiste, mirëpo të njëjtën nuk e kishin vërtetuar në Gjykatë, bazuar në deklaratën e dhënë nga nipi i saj

Andaj, komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për marrëdhëniet banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).

Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/12

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Agjencia shpallet jo kompetente për kërkesën me numër KB-1725/23 e parashtruar nga _____ ku bartësi i së drejtës banesore është _____ e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.02.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga Ndërmarrja: "Sigma" Prishtinë
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.02.2025 me anë të cilit Agjencia shpallet jo kompetente sa i përket kërkesës së palës _____ ku bartësi i së drejtës banesore është _____ për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga Ndërmarrja: "Sigma" Prishtinë.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala i ka nuk i plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës nga AKP pasi që subjekti juridik Ndërmarrja: "Sigma" Prishtinë nuk është NSh dhe nuk bie nën juridiksionin administrativë të Agjencisë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/13

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247); Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore dhe Ligjin për Trepçën Ligji Nr.05/L-120, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet bartja e kërkesave të pa përmbyllura nga AKP të "Trepça" Sh.A. për ato banesa të cilat janë ndarë në shfrytëzim nga njësitë e ndërmarrjes "Trepça" të cilat sipas Ligjit për Trepçën dhe sipas Statusit të ndërmarrjes publike "Trepça" Sh.A. kanë kaluar në pronësi të ndërmarrjes Publike "Trepça" Sh.A.
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që me menaxhmentin e ndërmarrjes "Trepça" të bëjnë pranim dorëzimin e kërkesave në fjalë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit të banesave me anë të cilit rekomandohet bartja e kërkesave të ShA "Trepça" të 3 (tri) kërkesave të ShA "Trepça" të mbetura pranë Komisionit për Banesa (3 kërkesat e pa përmbyllura për blerjen e banesave për faktin se parashtruesit e kërkesave nuk i kanë bërë pagesat sipas afatit ligjor) të cilat janë ndarë në shfrytëzim nga njësitë e Ndërmarrjes Publike "Trepça" Sh.A.. Meqenëse Agjencia është shpallur jo kompetente lidhur me të gjitha kërkesat për blerjen e banesave të cilat janë ndarë në shfrytëzim nga njësitet e ndërmarrjes "Trepça" e të cilat kanë kaluar në pronësi të Ndërmarrjes Publike "Trepça" Sh.A.Nga themelimi i Komisionit për Banesa janë pranuar, shqyrtuar dhe vendosur një numër i konsiderueshëm i kërkesave (198) për blerjen e banesave, të cilat ishin ndarë në shfrytëzim të përhershëm punëtorëve nga ndërmarrja shoqërore "Trepça" deri në ndërrimin e statusit ligjor të ndërmarrjes "Trepça" Sh.A.ne vitin 2016. Në rastin konkret Komisioni ka në dispozicion 3 (tri) kërkesa të pa përmbyllura me kontratë për blerjen e banesave, pronare e të cilave është Ndërmarrja "Trepça". Kërkesat janë të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve, dhe arsyeja e mos përmbylljes së kërkesës me kontratë është se parashtruesit e kërkesave janë njoftuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve, por palët nuk kanë sjellë dëshmi mbi pagesat. Parashtruesit janë:

Duke pas parasysh ato që u thanë më lartë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/14

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Neni 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokollit 44948/2023 në mes të NSh "KB Kosova" dhe qiramarrësit Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferim të Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e Tokës Bujqësore P-7140900300954 dhe P-71409003-00955-1 me sipërfaqe 10172 ZK Banullë, Lipjan nga në shumën prej 100 Euro për një vit kalendarik për pronën e NSh "KB Kosova".
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratës të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Pala është Qiramarrës i Tokës Bujqësor parcelat me nr. P-7140900300954 dhe P-71409003-00955-1 me sipërfaqe 10172 ZK Banullë, Lipjan që nga dt. 16.02.2023. Ka qenë qiradhënie përmes tenderimit publik. Qiramarrësi aktualisht nuk ka borxh të paguar.

Më 10.01.2025 ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokollit 25990/2025 të nënshkruar nga personat fizik të cilët kërkojnë që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga në emër të që njëherit janë anëtar te familjes të dy vëllezër. Parashtruesi i kërkesës është i gatshëm të vazhdoj qiramarrjen dhe paguaj qiranë me rregull në emër të

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave për ndërmarrjen, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësit aktual nuk kanë ndonjë borxh të paguar.


Ky aset nuk është në listën e asetëve të propozuara për fondin sovran dhe nuk është ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/15

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Neni 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokollit OUT- 46913/2023; OUT- 46914/2023; OUT- 46915/2023 dhe OUT- 47313/2023 në mes të NSh “Zhupa Reqane” dhe qiramarrësit Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferim të Kontratave të Qirasë për shfrytëzimin e lokaleve afariste 1, 2, 3 dhe 4 ne fshatin Recan, Komuna e Prizrenit. Kontratat për Lokalet 1, 2 dhe 3 të përfshihen në një Aneks kontratë për vazhdimin e tyre nga për pronën e NSh “Zhupa Reqane”.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Pala është Qiramarrës i aseteve (lokaleve) në Recan, Komuna e Prizrenit me sipërfaqe prej 50m2 (Lokali 1), 55m2 (Lokali 2), 70m2 (Lokali 3) dhe 25m2 (Lokali 4). Këto asete janë aprovuar për qiradhënie përmes tenderimit publik sipas dy Vendimeve të Bordit Nr. Ref. BD-75/11 të datës 27.01.2023 dhe Nr. Ref. BD-182/1 të datës 06.06.2023. Më 29.01.2025 ZR Prizren ka pranuar shkresën me nr. protokollit 26572/25-IN nga personi fizik (qiramarrësi aktual), i cili kërkon që të bëhet transferi i qirasë tek kompania

. Në bazë të certifikatës së regjistrimit në ARBK vërtetohet që është pronar i vetëm dhe njëherësh Përfaqësues i Autorizuar i

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratave të Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Këto asete nuk janë në listën e aseteve të propozuara për fondin sovran dhe nuk janë ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik pasi që janë në bashkëpronësi ½ me KK Prizren dhe është e pa mundur për tu bërë shitja. NSh Zhupa Reqane e ka në pronësi katin përdhese ndërsa Komuna katin e dytë dhe gjithashtu pjesën e tokës e kanë në pronësi me ½.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/16

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkruara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSh "Tregu" dhe parashtruesve të këtyre kërkesave, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë tek NSh Tregu:
1. Nga Shefik Latifi si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr.12/A në sipërfaqe prej 47m2, e cila ndodhet në Tregun me Shumicë tek "Bunjamin Beqiri" në shumën prej 103.40 Euro/muaj;
 2. Nga Et'hem Haxhijaha si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 2, me sipërfaqe prej 2 m2 në Tregun e Gjellbër tek "Nysret Haxhijaha" në shumën prej 60.00 Euro/muaj;
 3. Nga Ismet Hajdari si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 4, me sipërfaqe 2m2 në Tregun e Gjellbër tek "Nisret Hajdari" në shumën prej 80.00 Euro/muaj;
 4. Nga Suzana Krasniqi si qiramarrëse e tokës afariste e identifikuar me nr. 135, me sipërfaqe prej 1m2 në Tregun e Gjellbër tek "Marigona Krasniqi" në shumën prej 15.00 Euro/muaj;
 5. Nga Halil Muja si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 132, me sipërfaqe prej 2m2 në Anex Tregun e Gjellbër tek "Maliq Muja" në shumën prej 30.00 Euro/muaj;
 6. Nga Limon Gashi si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 134, me sipërfaqe prej 2 m2 në Anex Tregun e Gjellbër tek "Maliq Muja" në shumën prej 30.00 Euro/muaj;
 7. Nga Bedri Breznica si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 34, me sipërfaqe prej 6m2 në Tregun e Gjellbër tek "Lavdie Breznica" në shumën prej 80.00 Euro/muaj;
 8. Nga Vehbi Berisha si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 41, me sipërfaqe prej nuk aplikohen m2 në shumën prej 150.00 Euro/muaj si dhe tokës afariste nr. 42 me sipërfaqe nuk aplikohen m2 në shumën prej 150.00 Euro/muaj, në Tregun Pemë Perime, tek "Gani Berisha" ;
 9. Nga DPT Veli Enver Bislimi B.I. si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 6/B, me sipërfaqe nuk aplikohen m2 në Tregun me Shumicë tek "Veli Homë SH.P.K." në shumën prej 210.00 Euro/muaj;
 10. Nga Milazim Demolli si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 15, me sipërfaqe prej 100m2 në Tregun me Shumicë tek "Demolli Group SH.P.K." në shumën prej 300 Euro/muaj;
 11. Nga Valon Aliu/Audio Store si qiramarrës i tokës afaristee identifikuar me nr. 155, me sipërfaqe prej 14m2 në Tregun me Shumicë tek "My Music Store SH.P.K" në shumën prej 50.00 Euro/muaj;
 12. Nga Faton Rrahmani si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 2, me sipërfaqe prej 2m2 në Anex Tregun e Gjellbër tek "Edmond Rrahmani" në shumën prej 30.00 Euro/muaj;
 13. Nga DPT Stenda nr.25, si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 171, me sipërfaqe nuk aplikohen m2 në Tregun Pemë Perime në Prishtinë, tek "Horizon Foods L.L.C." në shumën prej 90.00 Euro/muaj;
- II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të transferuara tek personat e lartcekur dhe ndërrimit të emrit, Qiramarrësit aktual do të jenë të obliguar të paguajnë borxhin e papaguar, ose në të kundërtën do të ndermiren të gjitha veprimet ligjore për inkasimin e borxhit të papaguar dhe lirimin e hapësirave:
1. Qiramarrësi Shefik Latifi si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr.12/A në sipërfaqe prej 47m2, e cila ndodhet në Tregun me Shumicë para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit

M.H.



- të emrit) tek "Bunjamin Beqiri" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 2,838.62€ Euro;
2. Qiramarrësi Et'hem Haxhijaha si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 2, me sipërfaqe prej 2m2 në Tregun e Gjellbër para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Nysret Haxhijaha" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 163.78€ Euro;
 3. Qiramarrësi Ismet Hajdari si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 4, me sipërfaqe 2m2 në Tregun e Gjellbër para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Nisret Hajdari" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 147.8€ Euro;
 4. Qiramarrësja Suzana Krasniqi si qiramarrëse e tokës afariste e identifikuar me nr. 135, me sipërfaqe prej 1m2 në Anex Tregun e Gjellbër para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Marigona Krasniqi" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 27.72€ Euro;
 5. Qiramarrës Halil Muja si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 132, me sipërfaqe prej 2m2 në Anex Tregun e Gjellbër para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Maliq Muja" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 27.71€ Euro;
 6. Qiramarrësi Limon Gashi si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 134, me sipërfaqe prej 2m2 në Anex Tregun e Gjellbër para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Maliq Muja" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 27.71€ Euro;
 7. Qiramarrësi Bedri Breznica si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 34, me sipërfaqe prej 6m2 në Tregun e Gjellbër para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Lavdie Breznica" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 73.4€ Euro;
 8. Qiramarrësi Vehbi Berisha si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 41, me sipërfaqe prej nuk aplikohet m2 në Tregun Pemë Perime para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Gani Berisha" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 554.25 € Euro, si dhe për tokën afariste nr. 42 me sipërfaqe prej nuk aplikohet m2 në Tregun Pemë Perime para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Gani Berisha" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 554.25 € Euro;
 9. Qiramarrësi DPT Veli Enver Bislimi B.I. si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 6/B, me sipërfaqe prej nuk aplikohen m2 në Tregun me Shumicë tek "para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Veli Home SH.P.K." është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 581.94€ Euro;
 10. Qiramarrësi Milazim Demolli si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 15, me sipërfaqe prej 100m2 në Tregun me Shumicë para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Demolli Group SH.P.K." është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 554.24€ Euro;
 11. Qiramarrësi Valon Aliu/Audio Store si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 155, me sipërfaqe prej 14m2 në Tregun me Shumicë para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "My Music Store SH.P.K." është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 46.9€ Euro;
 12. Qiramarrësi Faton Rrahmani si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 2, me sipërfaqe prej 2m2 në Anex Tregun e Gjellbër para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Edmond Rrahmani" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 27.71€ Euro;
 13. Qiramarrësi DPT Stenda nr.25 si qiramarrës i tokës afariste e identifikuar me nr. 171, me sipërfaqe nuk aplikohen m2 në Tregun Pemë Perime në Prishtinë, para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "Horizon Foods L.L.C." është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 83.14€ Euro;
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.



ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Më datë 27/06/2024, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 25010/2024 e parashtruar nga pala z. Shefik Latifi shfrytëzues i tokës afariste nr. 12/A, për transferimin e kontratës të qirasë nga “Shefik Latifi” në emër të “Bunjamin Beqiri”.

Qiramarrësi Shefik Latifi ka hyrë në kontratë të qirasë me nr. protokolli 47456/2023 të datës 23/06/2023 për shfrytëzimin e tokës afariste e identifikuar me nr.12/A me sipërfaqe 47m2 të ndodhur Tregun me Shumicë në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve), në shumën prej 103.40 Euro/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 2,838.62 €. Në kërkesën e parashtruar, qiramarrësi ka kërkuar që transferimi i qirasë të bëhet nga data 01/02/2024.

Më datë 05.09.2024, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokolli 25329/2024 të parashtruar nga z. Nysret Haxhijaha, i biri i Et’hem Haxhijaha qiramarrës në NSH Tregu. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste nr. 2 nga “Et’hem Haxhijaha” në emër të “Nisret Haxhijaha” me arsyetimin që babai i tij është i moshuar dhe tash e një kohë hapësira në fjalë shfrytëzohet nga parashtruesi i kërkesës z. Nysret Haxhijaha.

Qiramarrësi aktual Et’hem Haxhijaha është shfrytëzues i tokës afariste nr.2, me sipërfaqe prej 2m2 në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 43702/2022 e datës 09.12.2022 në shumën prej 60€/muaj, e ndodhur në Tregun e Gjellbër, në Prishtinë (tek RTK-ja). I njëjti ka kontratë aktive të qirasë shuma e borxhit të papaguar është 163.78€. Më datë 10/12/2024, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokolli 25888/2024 të parashtruar nga z. Nisret Hajdari, i vëllau i Ismet Hajdari (tashmë i ndjerë) qiramarrës në NSH Tregu. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste nr. 4, nga “Ismet Hajdari” në emër të “Nisret Hajdari”.

Qiramarrësi (tashmë i ndjerë) Ismet Hajdari është shfrytëzues i tokës afariste nr. 4 me sipërfaqe 2m2 në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 43693/2022 e datës 09.12.2022 në shumën prej 80€/muaj, e ndodhur në Tregun e Gjellbër në Prishtinë (tek RTK-ja). I njëjti ka kontratë aktive të qirasë, ndërsa shuma e borxhit të papaguar është 147.8€ dhe ka kërkuar që transferimi i kontratave të qirasë të bëhet nga data 01.10.2024.

Më datë 17/12/2024, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokolli 25916/2024 të parashtruar nga z. Suzana Krasniqi qiramarrëse në NSH Tregu. Parashtruesja në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste nr. 135, nga “Suzana Krasniqi” në emër të “Marigona Krasniqi”. Qiramarrësja Suzana Krasniqi është shfrytëzuese e tokës afariste nr. 135, me sipërfaqe 1 m2 në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 43991/2022 e datës 12.12.2022 në shumën prej 15€/muaj, e ndodhur në Anex Tregun e Gjellbër në Prishtinë. E njëjta ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 27.72€.

Më datë 24/12/2024, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokolli 25944/2024 të parashtruar nga z. Halil Muja, qiramarrës në NSH Tregu. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste nr. 132, nga “Halil Muja” në emër të “Maliq Muja”. Qiramarrësi Halil Muja është shfrytëzues i tokës afariste nr. 132, me sipërfaqe 2m2 në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 44040/2022 e datës 12.12.2022 në shumën prej 30€/muaj, e ndodhur në Anex Tregun e Gjellbër në Prishtinë. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 27.71€.



Më datë 24/12/2024, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokoli 25943/2024 të parashtruar nga z. Limon Gashi, qiramarrës në NSH Tregu. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste nr. 134, nga "Limon Gashi" në emër të "Maliq Muja". Qiramarrësi Limon Gashi është shfrytëzues tokës afariste nr. 134, me sipërfaqe 2m² në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 43971/2022 e datës 12.12.2022 në shumën prej 30€/muaj, e ndodhur në Anex Tregun e Gjelbër në Prishtinë. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 27.71€.


Më datë 08/01/2025, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokoli 25962/2025 të parashtruar nga z. Bedri Breznica qiramarrës në NSH Tregu. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste nr. 34, nga "Bedri Breznica" në emër të "Lavdie Breznica". Qiramarrësi Bedri Breznica është shfrytëzues i tokës afariste nr. 34, me sipërfaqe 6m² në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 43652/2022 e datës 09.12.2022 në shumën prej 80€/muaj, e ndodhur në Tregun e Gjelbër në Prishtinë (tek RTK-ja). I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 73.4€. Parashtruesi ka kërkuar që transferimi i kontratave të qirasë të bëhet nga data 01.01.2025.

Më datë 29/01/2025, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokoli 26069/2025 të parashtruar nga z. Vehbi Berisha, qiramarrës në NSH Tregu. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratave të qirasë për tokën afariste - nr. 41 & 42, nga "Vehbi Berisha" në emër të "Gani Berisha". Qiramarrësi Vehbi Berisha është shfrytëzues i tokës afariste nr. 41 me sipërfaqe nuk aplikohet m² në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 47192/2023 e datës 21/06/2023 në shumën prej 150€/muaj, si dhe shfrytëzues i tokës afariste nr. 42 me sipërfaqe nuk aplikohet m² në bazë të kontratës së qirasë nr. prot. 47193/2023 të datës 21.06.2023 në shumën prej 150€/muaj, të ndodhura në Tregun Pemë Perime në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve). I njëjti ka kontrata aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar për tokën afariste nr. 41 është 554.25€ dhe për borxhi për tokën afariste nr. 42 është 554.25€.

Më datë 29/01/2025, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokoli 26072/2025 të parashtruar nga z. Enver Bislimi, qiramarrës në NSH Tregu. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste – tokën nr. 6/B, nga "DPT Veli - Enver Bislimi B.I" në emër të "Veli Home SH.P.K". Qiramarrësi DPT Veli - Enver Bislimi B.I është shfrytëzues i tokës afariste nr. 6/B, me sipërfaqe nuk aplikohet m² në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 47376/2023 e datës 22.06.2023 në shumën prej 210€/muaj, e ndodhur në Tregun me Shumicë në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve). I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 581.94€.

Më datë 29/01/2025, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokoli 26074/2025 të parashtruar nga z. Lavdim Demolli & Demolli Group SH.P.K. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste - nr. 15 nga "Milazim Demolli" në emër të "Demolli Group SH.P.K." me përfaqësues Lavdim Demolli. Qiramarrësi Milazim Demolli është shfrytëzues i tokës afariste nr. 15 me sipërfaqe 100m² në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 47481/2023 e datës 23.06.2023 në shumën prej 300€/muaj, e ndodhur në Tregun me Shumicë në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve). I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 554.24€.

Më datë 29/01/2025, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokoli 26071/2025 të parashtruar nga z. Valon Aliu, qiramarrës në NSH Tregu. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste nr. 155 nga "Audio-Store" në emër "My Music Store SH.P.K." Qiramarrësi Valon Aliu/ Audio Store është shfrytëzues i tokës afariste nr. 155, me 14m² në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 47444/2023 e datës 23.06.2023 në shumën prej 50€/muaj, e ndodhur në Tregun me Shumicë në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve). I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 46.9€.



Më datë 29/01/2025, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokoli 26078/2025 të parashtruar nga z. Edmond Rrahmani, i vëllau i Faton Rrahmanit (tashmë i ndjerë) qiramarrës në NSH Tregu. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste nr. 2, nga "Faton Rrahmani" në emër të "Edmond Rrahmani". Qiramarrësi Faton Rrahmani (tashmë i ndjerë) është shfrytëzues i tokës afariste nr. 2, me sipërfaqe 2m2 në bazë të kontratës së qirasë me nr. prot. 44034/2022 e datës 12.12.2022 në shumën prej 30€/muaj, e ndodhur në Anex Tregun e Gjellbër në Prishtinë. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 27.71€.

Më datë 18/02/2025, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokoli 26177/2025 të parashtruar nga z. Ilmi Kuleta, qiramarrës në NSH Tregu. Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj shkrese ka kërkuar transferimin e kontratës së qirasë për tokën afariste nr. 171, nga "DPT Stenda nr.25" në emër të "Horizon Foods L.L.C.". Qiramarrësi DPT Stenda nr.25 është shfrytëzues i tokës afariste nr. 171, me sipërfaqe nuk aplikohet m2 në bazë të kontratës së qirasë me nr. prot. 47175/2023 e datës 21.06.2023 në shumën prej 90€/muaj, e ndodhur në Tregun Pemë-Perime në Prishtinë. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 83.14

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratave të Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke mundësuar kështu ritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Duke qenë se NSH Tregu është me karakter specifik dhe hapësirat e vendosura në tokën afariste janë të ndërtuara nga vetë qiramarrësit dhe të lejohet transferimi i kontratave të qirasë edhe pse në mes të qiramarrësit dhe personit që pranon transferimin e kontratës së qirasë nuk ka lidhje familjare dhe të kihet parasysh se cedimi apo transferimi i këtyre kontratave të qirasë ju bëhet personave që ushtrojnë veprimtari të tregtisë.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/17

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokollit 118 në mes të NSh "Auto Prishtina" dhe qiramarrësit N.T.Sh. Tosi, përfaqësuar nga Isa Rizvanolli, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratës së qirasë nga qiramarrësi aktual N.T.Sh. Tosi për kontratën e vazhduar me aneks kontratën me nr. protokollit 54491/2024 për shfrytëzimin e lokalit afarist në sipërfaqe prej në sipërfaqe prej 155 m2 dhe tokës me sipërfaqe prej 159 m2 me çmimin prej 500.00 EUR/muaj tek Selmans Network Sh.P.K. për pronën e NSh "Auto Prishtina".
- II. Obligohet pala që para nënshkrimit të kontratës së qirasë sipas kërkesës për transfer të paguajë pjesën e borxhit në shumën prej 1,927.90 Euro.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

N.T.Sh. Tosi përfaqësuar nga Isa Rizvanolli ka kontratë të qirasë që nga data 16.01.2015 dhe këto kontrata kanë qenë të trashëguara dhe që është hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë në bazë të shfrytëzimit të aseteve.

Më 13.01.2025 ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokollit 25996/2025 të parashtruar nga përfaqësuesi i N.T.Sh. Tosi, me përfaqësues z. Isa Rizvanolli, të cilët kërkojnë që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga N.T.Sh. Tosi në kompaninë Selmans Network Sh.P.K.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësit aktual nuk kanë ndonjë borxh të paguar. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes ka vazhduar pa ndërprerje deri më sot, si dhe qiramarrësi aktualisht ka borxh në shumën prej 1,927.90 Euro të cilat do të jetë i obliguar të i paguajë para nënshkrimit të kontratës sipas vendimit mbi transferim të kontratës së qirasë.

Ky aset nuk është në listën e aseteve të propozuara për fondin sovran dhe nuk janë ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik dhe kanë qenë të shpallura si asete me interes publik.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/18

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.5 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimimin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të:

- I. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga/stenda nr.30 - Tregu në Ulpianë sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 47.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Arben Gajtani.
- II. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga/stenda nr.31 - Tregu në Ulpianë sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 47.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Adem Gajtani.
- III. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga/stenda nr.124 dhe 148 - Tregu në Ulpianë sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 91.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Mustafë Berisha.
- IV. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga/stenda nr.102, 103, 104 - Tregu në Ulpianë sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 175.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Shaqir Shillova.
- V. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga/stenda nr.97 – Tregu në Ulpianë sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 91.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Sabrie Pacolli.
- VI. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga/stenda nr.82 - Tregu i Gjellbër sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 51.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Amir Mehmeti.
- VII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga/stenda nr.143 - Anex Tregu i Gjellbër sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 36.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Fatmir Stublla.
- VIII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga/stenda nr.118 - Anex Tregu i Gjellbër sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 25.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Ali Vitija.
- IX. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 9A - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 196.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Mustafë Beqiri.
- X. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 64 dhe 63 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 241.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Gazmend Abazi.
- XI. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 133 - Tregu me Shumicë - Pemë dhe Perime (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 90.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Blerim Gerbeshi.
- XII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur kioska nr.35 dhe depo nr.23/B - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 28.00€/muaj për një muaj për kioskën nr.35 ndërsa për depon nr.23/B parashtruesin e kërkesës Florim Stublla

MH



- përfaqësues i kompanisë “Erona Bau”SH.P.K është përcaktuar çmimi i qirasë në vlerë prej 75€/muaj.
- XIII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 1/A - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 361.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Januz Beqiri.
- XIV. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 541 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 83.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Hajdar Rushiti.
- XV. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 8/A - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 99.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Fahri Lahu.
- XVI. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 7/A - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 96.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Te Samia SH.P.K – Sami Lahu.
- XVII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 4/B - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 166.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Fadil Leci.
- XVIII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 8/A1 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 93.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Hilmi Haliti.
- XIX. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 24/B - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 96.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Driton Gashi.
- XX. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 7/B - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 222.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Besart Sinani.
- XXI. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 311, 314, 333 dhe 402 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 180.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Berat Metolli dhe EDI SH.P.K.
- XXII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 444, 445, 431, 430 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 103.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Bislim Bislimi.
- XXIII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 1/C - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 297.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Rexhep Beqiri.
- XXIV. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 74 - Tregu me Shumicë – Pemë dhe Perime (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 188.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Bekim Vokri.
- XXV. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 14A - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 371.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Salih Beqiri.
- XXVI. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 20A - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 157.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Muharrem Beqiri.
- XXVII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 134 - Tregu me Shumicë- Pemë dhe Perime (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 180.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Muhamet Hoti.
- XXVIII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 6/A - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 184.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës NTP Bizhuteria te Noli.



- XXIX. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 710, 711, 712, 717, 718, 719 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 160.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Adem SH. Gashi.
- XXX. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 150 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 172.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Ilmi Agushi.
- XXXI. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 536, 580, 581, 709, 720 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 137.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Festim Popova.
- XXXII. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 5, 7, 12, 16, 17, 61, 62 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 276.00€/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Luan Xheladini (Hekraria Te Luani SH.P.K).

II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive parashtruesit e kërkesave para nënshkrimit të kontratave të qirasë do të duhet të paguajnë shumat si në vijim:

1. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga nr.30 - Tregu Ulpiana parashtruesi i kërkesës Arben Gajtani duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar shumë prej 282€ - respektivisht (47€/6 muaj).
2. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga nr.31 - Tregu Ulpiana parashtruesi i kërkesës Adem Gajtani duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar shumë prej 282€ - respektivisht (47€/6 muaj).
3. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga nr.124 dhe 148 - Tregu Ulpiana parashtruesi i kërkesës Mustafë Berisha duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajin e kaluar shumë prej 91€ - respektivisht (91€/1 muaj).
4. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga nr.102, 103, 104 - Tregu Ulpiana parashtruesi i kërkesës Shaqir Shillova duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 7 muajt e kaluar shumë prej 1,225€ - respektivisht (175€/7 muaj).
5. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga nr.97 - Tregu Ulpiana parashtruesi i kërkesës Sabrie Pacolli duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 7 muajt e kaluar shumë prej 637€ - respektivisht (91€/7 muaj).
6. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga nr.82 - Tregu i Gjellbër parashtruesi i kërkesës Amir Mehmeti duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 7 muajt e kaluar shumë prej 357€ - respektivisht (51€/7 muaj).
7. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga nr.143 - Anex Tregu i Gjellbër parashtruesi i kërkesës Fatmir Stublla duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muajt e kaluar shumë prej 72€ - respektivisht (36€/2 muaj).
8. Tokë afariste në të cilën është e vendosur tezga nr.118 - Anex Tregu i Gjellbër parashtruesi i kërkesës Ali Vitija duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar shumë prej 150€ - respektivisht (25€/6 muaj).
9. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.9A - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Mustafë Beqiri duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muajt e kaluar shumë prej 392€ - respektivisht (196€/2 muaj).
10. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.64 dhe 63 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Gazmend Abazi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 4 muajt e kaluar shumë prej 964€ - respektivisht (241€/4 muaj).
11. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.133 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Blerim Gerbeshi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar shumë prej 540€ - respektivisht (90€/6 muaj).



12. Tokë afariste në të cilën është e vendosur kioska nr.35 dhe depo nr.23/B - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) për parashtruesin e kërkesës Florim Stublla përfaqësues i kompanisë "Erona Bau"SH.P.K duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për muajin e kaluar shumë prej 103€ - respektivisht (103€/1 muaj).
13. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 1/A - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Januz Beqiri duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për muajin e kaluar shumë prej 361€ (Shkurt (1 muaj) x 361.00 € = 361€).
14. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 541 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Hajdar Rushiti duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për muajin e kaluar shumë prej 83.00€/muaj për një muaj Shkurt (1 muaj) * 83.00€=83.00€).
15. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.8/A - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Fahri Lahu duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për muajin e kaluar shumë prej 99€ - respektivisht (99€/1 muaj).
16. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 7/A - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) për parashtruesin e kërkesës Te Samia SH.P.K – Sami Lahu duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për muajin e kaluar shumë prej 96€ - respektivisht (96€/1 muaj);
17. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr. 4/B - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) për parashtruesin e kërkesës Fadil Leci duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 4 muaj shumë prej 664€ - respektivisht (166€/4 muaj);
18. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.8/A1 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Hilmi Haliti duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar shumë prej 93€ - respektivisht (93€/1 muaj).
19. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.24/B - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Driton Gashi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 3 muajt e kaluar shumë prej 288€ - respektivisht (96€/3 muaj).
20. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.7/B - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Besart Sinani duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajin e kaluar shumë prej 222€ - respektivisht (222€/1 muaj).
21. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.311, 314, 333 dhe 402 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Berat Metolli dhe EDI SH.P.K. duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 5 muajt e kaluar shumë prej 900€ - respektivisht (180€/5 muaj).
22. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.444, 445, 431, 430 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Bislam Bislimi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajin e kaluar shumë prej 103€ - respektivisht (103€/1 muaj).
23. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.1/C - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Rexhep Beqiri duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajin e kaluar shumë prej 297€ - respektivisht (297€/1 muaj).
24. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.74 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Bekim Vokri duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajin e kaluar shumë prej 188€ - respektivisht (188€/1 muaj).
25. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.14A - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Salih Beqiri duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muajt e kaluar shumë prej 742€ - respektivisht (371€/2 muaj).
26. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.20A - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Muharrem Beqiri duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muajt e kaluar shumë prej 314€ - respektivisht (157€/2 muaj).
27. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.134 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Muhamet Hoti duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar shumë prej 540€ - respektivisht (90€/6 muaj).



28. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.6/A - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës NTP Bizhuteria te Noli duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar shumë prej 1104€ - respektivisht (184€/6 muaj).
 29. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.710, 711, 712, 717, 718, 719 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Adem SH. Gashi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar shumë prej 960€ - respektivisht (160€/6 muaj).
 30. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.150 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Ilmi Agushi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar shumë prej 860€ - respektivisht (172€/5 muaj).
 31. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.536, 580, 581, 709, 720 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Festim Popova duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar shumë prej 822€ - respektivisht (137€/6 muaj).
 32. Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nr.5, 7, 12, 16, 17, 61, 62 - Tregu me Shumicë parashtruesi i kërkesës Luan Xheladini përfaqësues i kompanisë Hekraria Luani SH.P.K, duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 4 muajt e kaluar shumë prej 1104€ - respektivisht (276€/4 muaj).
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër - ku sipërfaqja e tokës që N.Sh-ja menaxhon është në bashkëpronësi me persona privatë (1/3 e sipërfaqes së përgjithshme në pronësi të "Ndërmarrja Tregu" dhe pjesa tjetër në pronësi të bashkëpronarëve të cilëve u paguan qira mujore në vlerë totale prej 3,000Euro);
2. Tregu në Ulpianë - një pjesë e pronës evidentohet në emër të PSh. NDERMARRJA TREGTARE VOQAR me numër të ngastrës P-71914059-02779-4, me shfrytëzim të parcelës Tokë Ndërtimore - Oborr dhe sipërfaqe prej 1008m², në ZK Prishtinë, kurse pjesa e ngastrave me nr. 2779-0 dhe 7435-0 që kufizohen me këtë parcelë kanë mungesë të dhënave tekstuale.
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë, në bazë të Certifikatës së Pronësisë të gjeneruar nga shërbimet digjitale të AKK-së, me nr. të lëndës AKP-TREGU_23072024, evidentohet në emër të P.Sh.FABRIKA E AMORTIZATORËVE, me numër të ngastrës P-71914059-01560-13, kulturë arë e klasës së 3 dhe sipërfaqe prej 64830m², në ZK Prishtinë, kurse një pjesë e ngastrave që kufizohen me parcelën e NSh Amortizatorëve me nr. P-71914059-01571-2 dhe P-71914059-01567-4 evidentohen në emër të P.SH SHKOLLA MESME BUJQESORE, kurse pjesa tjetër e parcelave me nr.P-71914059-01559-000 dhe P-71914059-01560-0 ZK Prishtinë: Nuk ka të dhëna.

Në bazë të Fletës Poseduese të lëshuar nga Komuna e Prishtinës e datës 13.09.2002 dhe vendimit mbi caktimin e lokacionit për dislokimin e tregut të gjellbërt me shumicë të qytet të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 06.12.2001 është caktuar dislokimi i Tregut të Gjellbër me shumicë të qytetit të Prishtinës në ngastrën kadastrale nr.1559/14 e evidentuar në fletën poseduese nr.4137 ZK Prishtinë me sipërfaqe prej 3.00ha, kjo ngastër e cekur në këtë vendim në bazë të kontrollimit në gjeoportali nuk figuron që të jetë në vendin e njëjtë që tani e shfrytëzon ndërmarrja Tregu (shih më lart nr. E parcelës së NSH Amortizatorët). Në bazë të CP të gjeneruar nga shërbimi digjital i AKK-së, ngastra me nr. 1559/14 evidentohet në emër të P.Sh.INST.PËR HULUMT.SHKENC.NË BUJQËSI D.S.INST.ZA.

Duke qenë se NSh "Tregu" është ende në proces likuidimi, hapësirat e saj afariste vijojnë të jenë objekt i qiradhënies, në mënyrë që të sigurohen të ardhura për administrimin dhe likuidimin e ndërmarrjes.



Në këtë kuadër, janë pranuar disa kërkesa për qiradhënie direkte nga individë dhe biznese, të cilat synojnë shfrytëzimin e hapësirave afariste të NSh "Tregu" në Tregun e Ulpianës, Tregun e Gjelbër dhe Tregun me Shumicë (Tekstil, Hekrari dhe Pemë-Perime) në Zonën Industriale në Prishtinë.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesit e këtyre kërkesave, tanimë edhe shfrytëzuesit e këtyre hapësirave do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Prona e cila do të vlerësohet për dhënie me qira, sipas dokumentacionit të poseduar nga AKP, ZR Prishtinë, dhe sipas listës së aseteve, është tokë afariste përkatësisht treg.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 376/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë për asetet të cilat nuk kanë mundur ti sigurojnë herën e parë e vendim të DE 349/2024, prandaj bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren janë matur asetet e mëposhtme dhe çmimi i hapësirave të ofruar me qira tek Tregu me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë, Tregu në Ulpianë dhe Tregu i Gjelbër tek RTK duhet të jetë sipas matjeve të paraqitura në raportin e vlerësimit.

Në bazë të konfirmimit edhe nga ana e Udhëheqësve të Ofruesit të Shërbimeve tek Tregu i Ulpianës, Tregu i Gjelbër dhe Tregu me Shumicë në Zonën Industriale në Prishtinë, palët kanë filluar shfrytëzimin e këtyre hapësirave nga datat që janë konfirmuar nga Udhëheqësit e 3 Tregjeve dhe të cilat kanë kërkuar njëherësh të hyjnë me qira.

Kësisoj, Autoriteti i Likuidimit konsideron që është e arsyeshme dhe legjitime që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga data kur secili ka hyrë në shfrytëzim të këtyre hapësirave. Andaj, nga palët do të kërkohet që para nënshkrimit të kontratës të paguajnë shumën e qirasë në mënyrë retroaktive nga datat e poshtëshënuara për secilin prej tyre.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/19

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenin 18.1.3, dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në, nenin 10.1.5 i Rregullores . Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirim të asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të asetit të NSh Veselin Maslesha në Prishtinë PRN213, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 767.00 € për një muaj për lokalin nr.3 për parashtruesin e kërkesës Hasan Berisha për pronën e NSh Ndërmarrja Botuese Veselin Maslesha në Prishtinë, PRN213 (në likuidim).
- II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive, duke e llogaritur nga prill 2024, ku me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së me Nr. Ref.BD-200/16 të datës 29 mars 2024 ky aset është vënë nën administrimin e AKP-së. Për shfrytëzimin e lokalit nr.3 qiramarrësit Hasan Berisha në sipërfaqe prej 81.19 m² në shumën prej 767.00 €/muaj do të i kërkohet të paguajë retroaktivisht shumën prej 8,437.00 €.
- III. Në qoftë se qiramarrësit nuk mund të paguajnë shumat për periudhat retroaktive para nënshkrimit të kontratës së qirasë, atëherë i lejohet riprogramimi i këtij borxhi, për një periudhë jo më tepër se gjashtë (6) muaj brenda periudhës së vlefshmërisë së kontratës së qirasë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Aseti i NSh Veselin Maslesha në Prishtinë është aset i ri, i cili me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së Nr. Ref.BD-200/16 të datës 29 mars 2024 ka hyrë nën administrim të AKP-së. Pas aprovimit të statusit është bërë identifikimi i asetit të NSh Veselin Maslesha, i cili gjendet në Rr. Dardania, BL-5, L-I-3, lokali me nr. 3 me sipërfaqe prej 73 m².

Pas identifikimit të lokalit është kuptuar se i njëjti shfrytëzohet nga Hasan Berisha dhe i është dërguar njoftimi për lirim të lokalit dhe të sqarojë bazën e shfrytëzimit dhe po ashtu të njëjtit kanë parashtruar edhe kërkesë në likuidim, kërkesë kjo e cila ju është refuzuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit në lidhje me lokalin në fjalë.

Për më tepër, të njëjtit kanë parashtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, e cila evidentohet me shenjën C-I-24-0010 dhe pretendojnë që posedojnë dokumenta që dëshmojnë pronësinë mbi asetin në fjalë dhe se gjatë tërë kësaj kohe e kanë mirëmbajtur dhe kanë bërë investime në këtë lokal.

Pas disa komunikimeve me të njëjtit, lokali është mbyllur më datë 06 shkurt 2025 dhe nga Avokati i familjes Berisha Agjencia është njoftuar që kanë parashtruar padi të re me propozim për masë të përkohshme ndaj mbylljes së lokalit dhe po ashtu të njëjtit kanë parashtruar kërkesë për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë më datë 10.02.2025.



Po ashtu, padë është parashtruar edhe ndaj statutit për përcaktimin e kësaj ndërmarrje si ndërmarrje shoqërore nga këto palë, duke parashtruar edhe propozim për masë të përkohshme, i cili propozim është refuzuar nga ana e DhPGjS, në lidhje me NSh-në dhe këtë aset të kësaj NSh-je, i cili në bazë të SDR-it dhe listës së asetëve është i vetmi aset i kësaj NSh-je.

Pasi që palët kanë parashtruar kërkesë që të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë dhe aktualisht të njëjtit janë shfrytëzues, është formuar komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut dhe kësaj më datë 20 shkurt 2025 është përgatitur Raporti i vlerësimit të çmimit të tregut të qirasë për qiradhënien asetit në fjalë.

Sipas vlerësimit të AL-së, -së, lidhja e Kontratës së Qirasë me palën do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Qiradhënia e kësaj hapësirave është e arsyeshme pasi që momentalisht është duke u shfrytëzuar nga kjo palë dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij.

Pala është duke e shfrytëzuar lokalin nga periudha të hershme dhe kanë kryer investime me pretendimin që lokali është pronësi e tyre dhe të njëjtit kërkojnë që të marrin lokalin me qira, duke deklaruar që lidhja e kontratës së qirasë nuk nënkupton që heqin dorë nga paditë dhe njohja e njëanshme e statutit të kësaj NSh-je.

Kësisoj, Autoriteti i Likuidimit konsideron që është e arsyeshme dhe legjitime që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga prill 2024 pasi që më datë 29 mars 2024 Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka nxjerrë vendimin Nr. Ref.BD-200/16 përmes të cilit kjo NSh është vendosur nën administrimin e AKP-së. Andaj, nga palët do të kërkohej që para nënshkrimit të kontratës të paguajnë shumën e qirasë në mënyrë retroaktive nga prilli 2024 deri në momentin e nënshkrimit të kontratës apo të i ri programohet brenda kontratës së qirasë.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrrojë padë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/20

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10.1.4 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të lokalit afarist nr. 138 të NSh Gërmia, me sipërfaqe totale prej 53 m², sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 199.00 bruto në muaj për palën Besnik Kaleci.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Me datë 29 tetor 2024 Agjencia ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25634/2024, të parashtruar nga z. Besnik Kaleci, përmes së cilës kanë adresuar kërkesën për marrje me qira të këtij lokalit afarist, për nevoja të zhvillimit të biznesit në fushën e tregtisë. Aktualisht, lokali afarist mbahet i mbyllur nga Agjencia- ZR Mitrovicë.

Pala më datë 23.01.2025 ka sjellë edhe pëlqimin e dhënë nga ana e KK Mitrovicë e Veriut, ku ofrohet mbështetje për marrjen me qira të këtij aseti me qëllim të hapjes së biznesit në këtë lokacion.

Sipas vlerësimit të AL-së Lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore dhe do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 591/2025 të u.d. Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalit nr.138 me sipërfaqe prej 53 metra katrorë, në shumën prej 199 Euro/muaj. Ky aset nuk është në listën e asetëve për Fond Sovran.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/21

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.4 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të lokalit afarist në Rr. 24 Nëntor lokalit Nr 15 i NSH Univerzal në Leposaviq, me sipërfaqe totale prej 62.34m², sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 143.00 bruto në muaj për palën kërkuese Rrahim Pacolli për nevoja te punonjësve te Bankës Ekonomike.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Me datë 3 shkurt 2025 Agjencia ka pranuar shkresën me nr. protokolli 5503/2025, të parashtruar nga z Rrahim Pacolli , përmes së cilës kanë adresuar kërkesën për marrje me qira të këtij lokalit afarist, për nevoja te punonjësve te Bankës Ekonomike te marre me qira muaj me pare nga AKP dhe kësisoj zgjerim të biznesit në fjalë.

Më parë, ky aset ishte shfrytëzuar me qira nga një palë private te cilit i është ndërprerë kontrata për shkak se nuk ka dashur ta vazhdojë. Aktualisht, lokalit afarist mbahet i mbyllur nga Agjencia– ZR Mitrovicë.

Pala më datë 18.02.2025 së bashku me kërkesën ka sjellë edhe pëlqimin e dhënë nga ana e KK Leposaviq, ku ofrohet mbështetje për marrjen me qira të këtij aseti me qëllim të hapjes së biznesit në këtë lokacion.

Sipas vlerësimit të AL-së Lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të NSH-së dhe do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 582a/2025 të u.d. Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalit nr.15 me sipërfaqe prej 62 metra katrorë, e cila gjendet në Rr. 24 nëntor pn, Leposaviq është në shumën prej 143 Euro/muaj.

Ky aset nuk është në listën e asetëve për Fond Sovran, por është i kategorizuar si aset për tu privatizuar nga AKP në valët e ardhshme të shitjes.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/22

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërliken me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në, neni 10.1.4 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte për parcelën nr. 02231-0 me sipërfaqe prej 15990 metra katrorë për kompaninë "Retail City Sh.P.K" sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 3,163.00 Euro/muaj për pronën e NSh Elan, Vushtrri MIT012.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Me datë 06.09.2024 ZQ Prishtinë ka pranuar kërkesën me numër protokollit 3681 nga Retail City Sh.P.K i cili ka shprehur interes të marr me qira asetën e lartpërmendur. Pala më datë 31.01.2025 ka sjellë edhe pëlqimin e dhënë nga ana e KK Vushtrri, ku ofrohet mbështetje për marrjen me qira të këtij aseti me qëllim të hapjes së biznesit në këtë lokacion. Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 587/2025 të u.d. Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për parcelën nr. 02231-0 me sipërfaqe prej 15990 metra katrorë, e cila gjendet në Rr. Indrit Cena pn, Vushtrri është në shumën prej 3,163.00 Euro/muaj.

Sipas vlerësimit të AL-së lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të NSh-së do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/23

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; neni 3.10.1 të Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore; dhe Neneve 590 dhe 597 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit që të bëhet rishikimi i çmimit të qirasë në bazë të kontratës së qirasë me nr. protokoli 4239 të datës 14.06.2017 të vazhduar me aneks kontratën e fundit me nr. protokoli 47112/2023 të datës 09.06.2023 deri në zgjidhjen e çështjes nga organet kompetente në lidhje me shfrytëzimin apo pronësinë e këtij aset, ashtu që çmimi i ri i qirasë të paraqesë vetëm pjesën e pompës së derivateve, pa përfshirë ngastrat kadastrale që janë objekt kontesti.
- II. Çmimi i ri do të jetë në bazë të rivlerësimit të çmimit aktual të qirasë.
- III. Obligohet Autoriteti i Likuidimit që të parashtojë padi ndaj palës së tretë që është duke e penguar shfrytëzimin e lirshëm dhe të plotë të asetit në emër të kompensimit të dëmit në bazë të pasurimit të pabazë për periudhën nga dhjetori 2024 deri në zgjidhjen e çështjes nga ana e organeve kompetente.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e çështjes sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Pala Ridvan Beqiri është Qiramarrës në bazë të kontratës së qirasë të lidhur më datë 14.06.2017 i pikës së karburanteve me të gjitha asetet dhe pajisjet përcjellëse, duke përfshirë edhe sipërfaqen tokësore të ngastrave kadastrale 04643-10 dhe 04643-9 ZK Vërbeshicë të evidentuara në emër të ndërmarrjes Jugopetrol.

Sipas një vendimi të lëshuar nga Komuna e Ferizajt më 05.10.1966, është bërë pranimi teknik i punëve të realizuara për ndërtimin e pompës së benzinës me rezervar nëntokësor në Brezovicë, të cilat punë janë investuar nga ndërmarrja Jugopetrol. Këtij vendimi i kishte paraprirë një vendim i mëhershëm i komunës në fjalë, i datës 17.02.1966, me anë të të cilit i ishte miratuar investitorit – ndërmarrjes Jugopetrol, ndërtimi i pompës së benzinës në Brezovicë. Sipas të dhënave nga zyra përkatëse rajonale, pompa është nën administrimin e AKP-së dhe është e tenderuar për qiradhënie më 08.06.2016.

Siç konfirmohet edhe nga ZR Prishtinë, pompa e Jugopetrol nuk është e ndërtuar në parcelat 04643-9 dhe 04643-10, mirëpo është e ndërtuar në parcelat 04657 dhe 04660, parcela që së fundmi kanë kaluar në pronësi të Hysen Kokallari në bazë të kontratës së shitblerjes me palë tjera të cilët veqëse e kanë pasur në pronësi private. Leja për ndërtimin e pompës ka qenë e dhënë që të ndërtohet në parcelat 04643-9 dhe 04643-10 ZK Vrbeshitice, mirëpo edhe pse është ndërtuar në ngastra tjera, së njëjtës në atë kohë i ishte bërë pranimi teknik dhe i ishte lejuar puna.

Më datë 16.12.2024, Agjencia ka pranuar kërkesë nga ana e qiramarrësit përmes së cilës kërkon pezullimin apo mos faturimin e kontratës së qirasë deri në zgjidhjen e problemeve pronësore që i janë krijuar si pasojë që prona në të cilën është ndërtuar pompa është në pronësi të personave privat dhe së fundmi është shitur tek palët e treta.



Pala ka njoftuar AKP-së që është duke hasur në probleme të vazhdueshme kohëve të fundit dhe se për këtë ka raportuar rastin edhe në Polici të Kosovës dhe se ka pasur konflikt me këto palë, madje më datë 15.07.2021 disa palë kanë parashtruar padi ndaj qiramarrësit për pengim posedim të parcelave kadastrale 04648-1; 04648-2 dhe 04648-3 ZK Verbeshticë. Për më tepër, deklaroi se i është kërkuar që të pagujë tani e tutje qiranë tek këta persona pasi që të njëjtit janë deklaruar si pronar dhe në vazhdimësi ka njoftuar AKP-në, në lidhje me tendecat e palëve që të bëjnë rrënimin e pikës së derivateve, pasi që sipas tyre është e ndërtuar në parcelën në pronësi private.

Pas pranimit të këtyre informatave, i jemi drejtuar Drejtorisë së inspektionit të Komunës së Shtërpcës me shkresën me nr. protokollit 54350/2024 të datës 22.11.2024 ku kemi parashtruar kërkesë për mos lejimin e rrënimin të pompës së derivateve e cila është pronë e NSh Jugopetrol dhe po ashtu me shkresën me nr. protokollit 54352/2024 të datës 22.11.2024 kemi kërkuar edhe historiatin e parcelës 04660 ZK Vërbeshticë.

Më datë 23.12.2024 kemi pranuar përgjigje me nr. protokollit 25940/2024, ku na është dërguar përshkrim i historiatit të parcelës me nr. 04660 ZK Verbeshticë, përmes së cilit vërehet qartë që ngastra në fjalë në sipërfaqe prej 1884 m², ndryshimin e parë të pronësisë e ka pasur në vitin 2007, ku nga Ilic Dobrasava ka kaluar në pronësi të Ilic Dragan. Ndryshimi i dytë ka ndodhur në vitin 2020 ku nga Ilic Dragana ka kaluar tek Ilic Aleksandra. Ndërsa, ndryshimi i tretë dhe i fundit ka ndodhur në shtator 2024 ku nga Ilic Aleksandra tek Hysen Kokallari.

Më datë 13.01.2025 kemi pranuar kërkesë nga KK Shtërpcë në lidhje me kërkesën për mos lejim të rrënimin të pikës së karburanteve, ku të njëjtit kanë deklaruar se në mungesë të resurseve humane nuk mund ta zgjidhin këtë problem në kuadër të Komunës së tyre dhe na kanë udhëzuar që të i shënojmë KK Ferizaj.

Sa i përket kërkesës për moslejimin e rrënimin të pikës së karburanteve nuk kishin kthyer përgjigje, andaj më datë 12.02.2025 i jemi drejtuar me shkresë Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Ferizajit për mos lejimin e rrënimin të pikës së karburanteve sepse ishin përsërtitur presionit për rrënim dhe largim të qiramarrësit nga pika e karburanteve. Ende nuk kemi pranuar përgjigje nga ana e KK Ferizaj.

Në vazhden e veprimeve tjera që kemi ndërmarrë është edhe padia me propozim për masë të përkohshme e datës 03.12.2024 drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nga Autoriteti i Likuidimit ndaj Komunës së Shtërpcës dhe Hysen Kokallarit si person i fundit mbi të cilin ka kaluar pronësia.

Më datë 23.01.2025, është pranuar aktvendimi C-III-24-0168 përmes të cilit është refuzuar propozimi për masën e përkohshme nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Poashtu, në lidhje me këto ngastra edhe më herët janë ndërmarrë veprime nga ana e AKP-së, ku me shkresën me nr. protokollit 40939/2022 të datës 25.05.2022 është bërë kërkesë pranë KK Shtërpcë që të bëhet azhurnimi në regjistrat kadastral dhe parcelat në fjalë të regjistrohen në pronësi shoqërore.

Për më tepër, edhe Departamenti Ligjor i AKP-së ka parashtruar padi më datë 08.11.2022 për vërtetimin e pronësisë në ngastrat në fjalë në ZK Verbeshticë ndaj disa palëve. Kjo lëndë është ende në proces.

Në kërkesën e palës, sqarohen problemet që është duke hasur dhe për më tepër i njëjti deklaroi se ka shkelje të ligjit dhe kontratës si pasojë e pamundësisë që të shfrytëzohet aset i në mënyrë të lirshme nga ana e tij, për shkak të problemeve ekzistuese pronësore që janë në lidhje me këto ngastra dhe kërkon zgjidhjen e problemit dhe mos faturim deri në zgjidhjen e rastit sa i përket problemeve pronësorë.

Aseti është i lëshuar me qira në bazë të kontratës së qirasë me nr. protokollit 4239 të datës 14.06.2017 të vazhduar me aneks kontratën e fundit me nr. protokollit 47112/2023 të datës 09.06.2023 në shumën prej 4,201.00 Euro (bruto) për një muaj kalendarik.



Sipas vlerësimit të AL-së, pezullimi dhe mos- faturimi i kontratës së qirasë për periudhën sa do të zgjat procesi gjyqësor dhe të qartësohet çështja e pronësisë në lidhje me ngastrat objekt kontesti.

Për më tepër, pezullimi i kontratës së qirasë është i mbështetur në problemet faktike me të cilat jemi duke u përballur edhe ne si institucion dhe po ashtu për shkak të këtyre paqartësive pala qiramarrëse është duke hasur në vështirësi dhe është duke ju kërkuar që të paguajë qiranë tek personat në pronësi të të cilëve janë parcelat në fjalë.

Zgjidhja e çështjes në këtë rast nënkupton edhe mundësinë që në rast se vendoset masë e përkohshme nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe i ndalohet palës së tretë shfrytëzimi, atëherë do të vazhdohet me faturim të plotë të palës tani qiramarrëse.

Ky aset nuk është i paraparë në listën e asetëve të cilat janë kategorizuar si asetë që mund të kalojnë në listën e asetëve që mund të i takojnë Fondit Sovran në rast të themelimit.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/24

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërliohen me nenin 2.2.1 të Ligjit mbi AKP-në; Neneve 3, 9.5 dhe 9.6 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit respektivisht aprovohet kërkesa për ndryshim të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-212/3 të datës 21 tetor 2024 dhe rrjedhimisht edhe të kontratës së qirasë me nr. protokoll 18974/2017 e datës 20/07/2024 e lidhur me qiramarrësin IP-KOS Sh.P.K., ashtu që të lidhet kontrata e qirasë për ngastrën kadastrale nr. P-01699-8 ZK Llapllasellë me sipërfaqe prej 1210 m² me çmimin prej 157.00 Euro/muaj për pronën e NSh "Ratar" PRN115
- II. Qiramarrësi do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 1,099.00 Euro për periudhën retroaktive nga data 01 gusht 2024 deri më datë 01 mars 2025.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e çështjes së qiradhënies sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Kontrata e qirasë me nr. protokoll 18974/2017 është lidhur më datë 20/07/2017 në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSh "Ratar" dhe qiramarrësit IP-KOS Sh.P.K. për ngastrën kadastrale P-1699-8 e cila në bazë të kontratës së qirasë është shfrytëzuar si tokë bujqësore. Kjo parcelë është dhënë me qira përmes tenderit publik, për sipërfaqen prej 4574 m² në shumën prej 567.00 për një vit kalendarik. Kontrata është vazhduar me aneks kontratën e qirasë me nr. protokoll 48076/2023 më datë 01.08.2023.

Më datë 17.07.2024, Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar që një pjesë e parkingut e parcelës shfrytëzohet si parking dhe një pjesë tjetër rrugë. Duke qenë se aseti kishte ndryshuar destinimin, atëherë në shtator 2024 është paraqitur propozimi nga ana e AL-së që të bëhet ndryshimi i destinimit dhe rrjedhimisht edhe ndryshimi i çmimit të qirasë.

Bordi përmes vendimit Nr. Ref. BD-212/3 më datë 21 tetor 2024, kishte aprovuar propozimin e Autoritetit të Likuidimit dhe kishte ndryshuar kushtet e kontratës së qirasë me nr. Protokoll 18974/2017 të datës 20/07/2017, ashtu që kishte aplikuar faktet që ekzistojnë dhe tanimë në bazë të vendimit pasqyrohej vetëm sipërfaqja që realisht shfrytëzohej, e që është 3984 m² dhe ishte ndryshuar çmimi nga sa ishte në shumën prej 567.00 Euro për një vit kalendarik (pasi që destinimi ishte bujqësor) në 612.00 Euro për muaj (tani pas ndryshimit të destinimit si tokë komerciale).

Pas dorëzimit të vendimit të Bordit të Drejtorëve palës, Agjencia ka pranuar kërkesën ku kërkohej që të reflektohet në kontratë sipërfaqja e saktë që e shfrytëzon vetëm IP-KOS Sh.P.K. dhe që për pjesën tjetër, për të cilën deri më tani kishte paguar kjo kompani, të obligohet të paguajë shfrytëzuesi aktual. Pas këtyre pretendimeve, edhe ZR Prishtinë ka konfirmuar faktet e tilla dhe ka konstatuar që një pjesë të parcelës P-01699-8 ZK Llapllasellë shfrytëzohet nga një palë tjetër, e cila palë veqëse ka parashtruar kërkesë për qiradhënie direkte, e cila kërkesë po ashtu do të trajtohet në këtë mbledhjen nga ana e Bordit të Drejtorëve.



Në bazë të ekspertizës vërehet që parashtruesi i kërkesës IP-KOS Sh.P.K. shfrytëzon vetëm pjesën prej 1210 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3984 m², që paraqet sipërfaqen e shfrytëzueshme.

Ndryshimi i vendimit të Bordit të Drejtorëve në lidhje me kërkesën e parashtruesit mundëson inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore, dhe do të paraqiste kështu gjendjen faktike dhe nuk do të dëmtonte asnjë palë në këtë proces.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/25

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit e 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërliken me nenin 2.2.1 të Ligjit mbi AKP-n, nenit 10.1.5 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të ngastrës kadastrale P-01699-8 ZK Llapllasellë me sipërfaqe totale prej 2774 m² pronë e NSh "Ratar" për parashtruesin e kërkesës Mehmet Mehmeti, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 425.50 Eur/muaj
- II. Obligohet parashtruesi i kërkesës që para lidhjes së kontratës së qirasë të paguajë shumën prej 2,978.50 Euro, për periudhën e shfrytëzimit nga data 01 gusht 2024 deri më datë 28.02.2025.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordia sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Më datë 14.01.2025 është pranuar kërkesa nga ana e Mehmet Mehmeti për qiramarrjen e pjesës së ngastrës kadastrale P-01699-8 ZK Llapllasellë, e cila pjesë ka qenë pjesë e kontratës së qirasë të lidhur me IP KOS Sh.P.K. të cilët e kanë pasur kontratë për tokë bujqësore dhe në bazë të vendimit të Bordit Nr. Ref. BD-212/3 të datës 21 tetor 2024 është ndryshuar destinimi i kësaj parcele, e cila tanimë na paraqitet si parcel me destinim komercial. E njëjta nuk ka qenë asnjëherë e lëshuar me qira dhe nuk është vendosur në qiradhënie përmes tenderimit publik.

Pas pranimit të vendimit të lartcekur të Bordit nga ana e përfaqësuesve të IP KOS Sh.P.K. të njëjtit kanë reaguar përsëri duke sqaruar që nuk e shfrytëzojnë të gjithë sipërfaqen e shfrytëzueshme të kësaj parcele, por pjese më e madhe shfrytëzohet nga palë të tjera. Pas këtyre pretendimeve, zyrtarët e ZR Prishtinës kanë dal në terren dhe kanë vërtetuar faktet e tilla, ashtu që parashtruesi i kërkesës siç ka bërë me dije është i gatshëm të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë, duke sqaruar se parcelën në fjalë në vitin 2007 e ka blerë nga dy palë dhe që nga ajo kohë ka investuar mjaftueshëm në këtë parcelë. Për këtë i njëjti, ka bashkëngjitur dëshmi.

Sipas vlerësimit të AL-së lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të NSh-së dhe do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 590-2025 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për ngastrën kadastrale P-01699-8 ZK Llapllasellë me sipërfaqe prej 2774 m² është në shumën prej 425.50 Euro për një muaj.

Duhet të kemi parasysh se sipërfaqja totale e parcelës në bazë të certifikatës së pronësisë është 4574 m² ku pjesë e parcelës P-01699-8 ZK Llapllasellë është edhe sipërfaqja prej 590 m² e cila shërben si rrugë, konkretisht nëpër këtë kalon magjistralja Prishtinë-Ferizaj dhe kësajsoj kjo sipërfaqe do të i largohet nga pjesa e qirasë së bashku me



pjesën e sipërfaqes prej 1210 m2 që shfrytëzohet nga IP KOS Sh.P.K. dhe për qiradhënie do të i llogaritet vetëm sipërfaqja prej 2774 m2.

Për më tepër, pala e arsyeton kërkesën e tij mbi bazën që shfrytëzimi i këtij aseti është bërë në bazë të kontratës së shitblerjes me palë të tjera që kanë prezantuar si dëshmi aktgjykim dhe se mbi këtë parcelë ka bërë investime. Pala, duke pasur parasysh që edhe kjo pjesë e parcelës është shfrytëzuar dhe ka qenë pjesë e kontratës me IP KOS Sh.P.K. deri më datë 31 korrik 2024, datë pas së cilës i ka ndryshuar edhe destinimi i shfrytëzimit, dhe duke qenë se për pjesën e mëhershme të shfrytëzimit kontrata ka qenë e lidhur me IP KOS Sh.P.K. dhe nuk ka ndonjë borxh, atëherë parashtruesi i kërkesës do të obligohet që nga data 01 gusht 2024 deri më datë 28 shkurt 2025 të paguajë shumën prej 2,978.50 Euro.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/26

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të NSh "Agrokosova" Prishtinë (PRN089) e bashkëngjitur në shtojcën 1;
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim


Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSh "Agrokosova" Prishtinë (PRN089);

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/27

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të NSh "Komel" Batusë, Prishtinë (PRN054) e bashkëngjitur në shtojcën 1;
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSh "Komel" Batusë, Prishtinë (PRN054);

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.

Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/28

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të NSh KB “Ponoshec” Pejë (PEJ026) e bashkëngjitur në shtojcën 1;
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSh KB “Ponoshec” Pejë (PEJ026).

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/29

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të NSh "Lidhja Auto Moto Kosova" Prishtinë (PRN064) e bashkëngjitur në shtojcën 1;
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSh "Lidhja Auto Moto Kosova" Prishtinë (PRN064).

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.



Menfor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/30

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të NSh “Prizren Trans”, Prizren (PRZ047) e bashkëngjitur në shtojcën I;
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që me publikimin e Listës përfundimtare të njoftohen punëtorët e NSH-së, se shpërndarja e fondeve të 20%-it për punëtorët legjitim mund të bëhet vetëm nëse shiten asetet e NSh “Prizren Trans”, Prizren (PRZ047), në likuidim.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve, të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSh Prizren Trans”, Prizren (PRZ047).

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/31

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të NSh “Ndërtimtaria” Deçan (PEJ061) e bashkëngjitur në shtojcën 1;
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që me publikimin e Listës përfundimtare të njoftohen punëtorët e NSH-së, se shpërndarja e fondeve të 20%-it për punëtorët legjitim mund të bëhet vetëm nëse shiten asetet e NSh “Ndërtimtaria ” Deçan (PEJ061) në likuidim.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim


Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve, të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSH “ Ndërtimtaria ” Deçan (PEJ061).

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/32

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores Nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve (DShALP), sipas nenit 72.5 dhe 72.6 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet lista përfundimtare e punëtorëve të NSh “Enti Për Punë Gjeodezike dhe Fotogrametrike”, Prishtinë (PRN057) e bashkëngjitur në shtojcën 1;
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të publikoj Listën përfundimtare, të aprovuar më lartë, sipas nenit 72.5 dhe 72.6 e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020.
- III. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që me publikimin e Listës përfundimtare të njoftohen punëtorët e NSH-së, se shpërndarja “Enti Për Punë Gjeodezike dhe Fotogrametrike”, Prishtinë (PRN057) në likuidim.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare të punëtorëve, të Aprovohet Lista përfundimtare e punëtorëve të NSh “Enti Për Punë Gjeodezike dhe Fotogrametrike”, Prishtinë (PRN057).

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullave të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave të Punëtorëve (KSHALP), Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059, të datës 15 tetor 2020, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/33

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 Për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Udhëzuesit për shpërndarjen e 20% miratuar nga Bordi më 29 Mars 2012, Amandamentit të Udhëzuesit për shpërndarjen e 20% miratuar nga Bordi në Maj 2013 dhe Politikave Operative të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që sipas rregulloreve në fuqi të bëj shpërndarjen e 20% e të ardhurave nga shitja, transferimi ose likuidimi i një ndërmarrje ose aseti i Ndërmarrjeve Shoqërore në vijim:

1. NSh "Agrokosova" Prishtinë (PRN089);
2. NSh "Komel" Batusë, Prishtinë (PRN054);
3. NSh KB "Ponoshec" Pejë (PEJ026).
4. NSh "Lidhja Auto Moto Kosova" Prishtinë (PRN064)

II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që sipas rregulloreve në fuqi të bëj shpërndarjen e 20% e të ardhurave nëse do të ketë shitje të aseteve të Nsh-ve në likuidim, në vijim:

1. NSh "Prizren Trans ", Prizren (PRZ047);
2. NSh "Ndërtimtaria " Deçan (PEJ061);
3. NSh "Enti Për Punë Gjeodezike dhe Fotogrametrike", Prishtinë (PRN057).

III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Departamenti Ligjor përkatësisht Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në listën përfundimtare për shpërndarjen e parakohshme të pjeshme të 20% të të ardhurave nga shitja, transferimi ose likuidimi i një ndërmarrje ose aseti i 7 Ndërmarrjeve Shoqërore të cekura në dispozitiv të këtij vendimi.

Në përputhje me nenin Nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, Udhëzuesin për shpërndarjen e 20% miratuar nga Bordi më 29 Mars 2012, Udhëzuesin e amendamentuar për shpërndarjen e 20% miratuar nga Bordi në Maj 2013 dhe Politikave Operative të AKP-së, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-219/34

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 27 shkurt 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Autoritetit të Likuidimit aprovim të korrigjimit për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Ingeniering (në likuidim) PRN129 nga Rajoni i Prishtinës, ashtu që anulohet vendimi i Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-200/28 të datës 29 mars 2024.
- II. Në listën për pagesë (shtojcën 3) janë të përfshirë pesë(5) kreditorë të ndarë në katërmbëdhjetë (14) pagesa në shumën totale prej 53,313.79 €.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes e përkohshme të korrigjuar për kreditorët e PRN129 NSh "Ingeniering" në likuidim sipas nenit 41.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes së Përkohshme të korrigjuar të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Ingeniering (në likuidim) PRN129 nga Rajoni i Prishtinës nga Rajoni i Prizrenit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 shkurt 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit